



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor  
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot. Tiranë / /2024**  
**Nr. Dok. 202300848/9**

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi me mjetet e nevojshme për kryerjen e matjeve të rrezatimeve jojonizuese me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale të përcaktuara me ligj.*

**INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK**

**TIRANË**

**ZYRËS SË MBROJTJES NGA RREZATIMI**

**TIRANË**

**Për dajeni: MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Në ankesën drejtuar Avokatit të Popullit, ku shtetasi I.M ka shprehur shqetësimin në lidhje me rreziqet shëndetësore që sjellin antenat telefonike të instaluar në tarracën e pallatit, ku banon, pranë stacionit të trenit në Vlorë.

Sikundër ai shkruan, si përfaqësues edhe i grupit të banorëve të pallateve në rrugën "Gjergj Kastrioti", Vlorë, kanë adresuar kërkesat e tyre në disa institucione shtetërore, ndër të cilat edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Po ashtu, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ankuesi evidentohet se edhe Prefekti i Qarkut Vlorë e ka ngritur shqetësimin që në datën 10.08.2023, pranë disa institucioneve përgjegjëse për rreziqet shëndetësore që

sjellin antenat telefonike të instaluara në tarracën e godinave të banesave. Ankuesi dhe banorët rezultojnë të kenë pretendime për faktin se prania e antenave të tilla paraqet rrezikshmëri të lartë për ta dhe se kjo situatë është kthyer në një shqetësim të përditshëm. Banorët kërkojnë që antenat e kompanive telefonike duhet të vendosen larg qendrave urbane, për shkak të nivelit të lartë të rrezatimit dhe se nga ana e institucioneve deri tani nuk janë marrë masa për zgjidhjen e kësaj problematike.

Në këto rrethana, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për sqarimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje. Me qëllim hetimin administrativ të çështjes<sup>1</sup> dhe vlerësimin e pretendimeve të ankuesit, në kuadër të të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, si dhe dhënie të vëmendjes për përmbushje të Objektivave të Agenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, më konkretisht të objektivit 3.D “Forcim i kapaciteteve të të gjitha vendeve, në veçanti të vendeve në zhvillim, për paralajmërim të hershëm, zvogëlimi i rrezikut dhe menaxhimin e rreziqeve kombëtare dhe globale të shëndetit”, kemi kërkuar me shkresën K3/I45 – 2 prot., datë 01.11.2023, “Kërkesë për shpjegime” Bashkisë Vlorë dhe me shkresën K3/I45 – 3 prot., datë 01.11.2023, “Kërkesë për shpjegime” Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) dhe Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi (ZMR).

Në përgjigjen e dhënë me shkresën nr. 13479/1 prot., datë 17.11.2023, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) pranë Bashkisë Vlorë jemi informuar se: “... Në bazë të verifikimeve të kryera nga I.M.T. Bashkia Vlorë, ka rezultuar se shoqëria “Vodafone Albania” sh.a. është e pajisur pranë institucioneve kompetente me leje ndërtimi nr. 430/35, datë 06.05.2018, për objektin “Zgjerimin e rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit “Vodafone Albania” nëpërmjet shtimit të antenave për 7 stacione bazë”. Ndodhur në këto kushte I.M.T Bashkia Vlorë, nuk mund të ndërmarrë asnjë sanksion”.

Ndërsa Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi, në përgjigje tonës, me shkresën nr. 297 prot., datë 10.11.2023, shoqëruar me relacionin përkatës (në të cilën bashkëlidhur ndodhej edhe shkresa nr. 208 prot., datë 01.08.2023 “Kthim përgjigje banorëve të pallateve”), na informon se: “... në zbatim të ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jononizuese”, Rregullores nr. 743, datë 16.10.2012, si dhe në përputhje me dokumentin nr. 6097.7, “Procedurat, formati shpjegues dhe vlerësimi i aplikimit për pajisjen me Akt Miratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jononizues, Formatit i Vërtetimit”, kompanitë e telefonisë celulare, të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre me burime rrezatimi jononizues aplikojnë pranë ZMR për t’u pajisur me Akt Miratimi. Pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar në ZMR, sipas dokumentit nr. 822.2 prot., datë 13.02.2013 “Metodologjia e llogaritjes së përmasave të zonave kritike të shpërhapjes së rrezatimit të një antene celulare”, miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, Stacionet Bazë të gjetura në përputhje me rregulloret në fuqi, pajisjen me Akt Miratimi nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet. Pajisja me akt miratimin

---

<sup>1</sup> Neni 13 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur verën ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”

*e këtyre stacioneve bazë siguron që kjo veprimtari është në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe publiku është i mbrojtur nga rrezatimet jojonizuese...ju bëjmë me dije se Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet nuk është autoriteti kompetent për marrjen e vendimit për vendosjen apo heqjen e antenave të Stacioneve Bazë, apo përcaktimin e vendinstalimit të stacioneve bazë. Nëpërmjet aktit të miratimit që lëshohet nga KMR, sigurohet se zona kritike rreth stacionit bazë nuk takohet me zonën ku qëndron publiku më i afërt. Vazhdimisht, që prej miratimit të ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, ZMR i është drejtuar me disa kërkesa zyrtare ISHP-së dhe MSHMS për sigurimin e pajisjeve matëse, me qëllim implementimin e kuadrit ligjor në fuqi. Deri më tani, këto kërkesa nuk kanë marrë zgjidhje dhe për këtë arsye ZMR nuk disponon pajisje për realizimin e matjeve.”*

Nisur nga përgjigja e mësipërme me qëllim kryerjen e një hetimi të thelluar administrativ, si dhe referuar legjislacionit në fuqi, ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, të ndryshuar (*ligj nr. 10469/2011*), i jemi ridrejtuar me shkresën “Kërkesë e përsëritur për shpjegime dhe dokumentacion” nr. K3/I45 – 7 prot., datë 27.08.2024, MSHMS-së, ISHP-së dhe ZMR-së, për të na informuar si vijon:

- Nëse ZMR kishte bërë kërkesa pranë ISHP për t’u pajisur me matësat për rrezatimin e nivelit të ulët (jojonizues) për antenat 3G, 4G, 5G;
- Nëse situata vazhdonte ende në mungesë të këtyre pajisjeve, si e arrinte realizimin e respektimit dhe përmbushjes së kërkesave të ligjit nr. 10469/2011, të ndryshuar;
- Nëse ZMR ishte pajisur me matësat, a ishin kryer matje për monitorimin e hapësirave që afektohen nga rrezatimet jojonizuese të përcjella nga antenat e kompanive celulare.

Me shkresën nr. 405/1 prot., datë 06.09.2024, ZMR-ja është përgjigjur si vijon:

*“Sqarojmë se mungesa e pajisjeve matëse të fushës elektromagnetike për antenat celulare, është një gjetje e evidentuar edhe nga auditimi i Inspektoratit Qendror më parë dhe Auditit i MSHMS në raportin përfundimtar përcjellë me shkresën nr. 3546/3 pro., datë 05.01.20204. Rekomandimi 1/c i raportit të Auditit të MSHMS, citon që: Instituti i Shëndetit Publik të dërgojë kërkesa të veçanta në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektorit të Investimeve), me qëllim vlerësimin e kërkesës brenda vitit 2024, në rast se nuk është e mundur atëherë të planifikohet në projekt buxhetin 2025-2027 për çeljen e fondit për pajisjet e kërkuara nga DMR (Drejtoria e Mbrojtjes nga Rrezatimet)...Rregullorja nr. 743, datë 16.10.2012 “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese” përcakton 3 elementë rregullatorë bazë (akt miratimi, inspektim, sanksione) për të rregulluar ekspozimin e publikut ndaj rrezatimeve jojonizuese, ku pajisja me akt miratimi është elementi me i rëndësishëm në lidhje me operimin e stacionit bazë. Pajisja me akt miratimi bëhet mbi bazën e një vlerësimi teknik nga ana e ekspertëve mbi bazat e parametrave maksimal të emetimit të stacioneve bazë, sipas të cilit publikut i mbivlerësohet ekspozimi nga rrezatimet jojonizuese, duke garantuar në këtë mënyrë që nivelet e ekspozimit të publikut janë më të ulëta se nivelet e referencës. Procesi i inspektimit kontrollon ruajtjen e parametrave të stacioneve bazë me kushtet e aktit të miratimit. Në mbështetje të Rregullores nr.743, datë 16.10.2012 “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”, pika 4.5*

*përcakton se mbrojtja nga rrezatimet jojonizuese dhe siguria e dhënë nga ekspertiza mbetet përgjegjësi e plotë e aplikantit dhe ekspertit. Implementimi i kërkesave ligjore nuk është i parregulluar, por ZMR nuk ka pajisjet e nevojshme për të kryer një inspektim të rregullt. Aktualisht Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet nuk disponon ende pajisje matëse”.*

Në përgjigjet e mësipërme evidentohet fakti se që në momentin e krijimit të ZMR-së dhe në zbatim të ligjit nr. 10469/2011, të ndryshuar, për më tepër se një dekadë kjo zyrë ka vepruar dhe vazhdon të ushtrojë veprimtarinë e saj pa bazën materiale të plotë.

Më konkretisht, në ligjin nr. 10469/2011, të ndryshuar, parashikohen qartësisht, përgjegjësitë dhe detyrat e KMR-së, si dhe funksioni ekzekutiv i ZMR-së, ndër të tjera, edhe kryerja e matjeve të rrezatimeve jojonizuese, si vijon:

- në nenin 5, parashikohet përgjegjësia e KMR-së: *“...Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet përcakton masat e nevojshme për të siguruar në çdo rast që ekspozimet e çdo instalimi ose pajisjeje që emeton rrezatim jojonizues të jenë në përputhje me normat e miratuara nga rregulloret përkatëse”.*
- në nenin 6, shkronjat b) dhe g) parashikohen detyrat e KMR-së: *“b) Kontrollon zbatimin në praktikë të akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizuese, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;...g) bashkëpunon me inspektoratin që mbulon fushën e punës dhe me inspektoratin që mbulon fushën e shëndetit.*
- në nenin 7 “Organet që kryejnë verifikimin e respektimit të kërkesave të këtij ligji” parashikon se: *Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet është njësi ekzekutive e KMR e cila kryen edhe këto detyra: ... c) Kryen inspektimin e instalimeve dhe veprimtarive me rrezatim jojonizues, në përputhje me ligjin për inspektimin; ç) Mbledh informacion dhe kryen matjet bazë e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;... e) Mban inventarin për të gjitha matjet e kryera kombëtare të instalimeve dhe regjistrat e posaçëm për të gjitha matjet e kryera.*

Duke evidentuar parashikimet në ligj kundrejt situatës faktike të paraqitur gjatë hetimit administrativ nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet se në funksionet e përcaktuara të ZMR-së dhe KMR-së dhe realizimit të detyrave që këto institucione kanë, ka një mospërbushje flagrante të detyrave thelbësore që ndikojnë në realizimin rigoroz të parashikimeve ligjore. Realizimi me përpikmëri i detyrave funksionale në përputhje me ligjin i këtyre institucioneve duhet të jetë në funksion të mbrojtjes në përditshmëri të shëndetit publik, mbrojtje e cila duhet të realizohet me monitorimin konkret dhe faktik të situatës.

Ndërkohë, problematika e mungesës së pajisjeve matëse, e cila është e domosdoshme për kryerjen e një prej detyrave kryesore të ZMR-së, dhe thelbësore për konstatimin dhe matjen e nivelit të rrezatimeve jojonizuese ndaj të cilave ekspozohet publiku, ka qenë fakt i ditur si i strukturave ekzekutuese por dhe atyre drejtuese nga e cila keni varësinë.

Vetë ISHP si institucioni përgjegjës për plotësimin e bazës materiale të ZMR-së, ka publikuar Manualin për “Menaxhimin Cilësor të Punës së ZMR-së”<sup>2</sup>, të miratuar nga Kryetari i ZMR-së më datë 04.06.2020, në të cilin evidentohet problematika e mungesës së aparaturave matëse që janë pjesë e procesit të punës të ZMR-së. Konkretisht, në pikën 7 të këtij Manuali evidentohet se: “ZMR-së nuk i janë vënë në dispozicion ende pajisje matëse për matjen e rrezatimit jojonizues.”, ndërsa në pikën 8 evidentohet se: “Nëse objektivat e caktuara të zbatimit të procesit nuk janë të përmbushura, kryhet analiza e shkaqeve të mundshme. Të dhënat për vlerësimin dhe kontrollin e proceseve mbahen në ZMR”.

Në shkresën e fundit nr. 405/1, datë 06.09.2024, të ZMR-së shpjegohet se: “...vlerësimi teknik bëhet nga ana e ekspertëve të njohur nga KMR dhe vlerësimi i specialistëve të ZMR-së dhe vendimmarrjes nga ana e KMR. Procesi i inspektimit kontrollon ruajtjen e parametrave të stacioneve bazë me kushtet e aktit të miratimit. Në mbështetje të Rregullores nr 743, datë 16.10.2012 “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”, pika 4.5 përcakton se mbrojtja nga rrezatimet jojonizuese dhe siguria e dhënë nga ekspertiza mbetet përgjegjësi e plotë e aplikantit dhe ekspertit.”.

Nga ana jonë konstatohet se në VKM-në nr. 743, datë 16.10.2012 “Për miratimin e Rregullores “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”, të ndryshuar (VKM nr. 743/2012) parashikohet: “4. Kriteret dhe procedurat për pajisjen me akt miratimi për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues. 4.1 Çdo person fizik ose juridik, që ushtron veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues, është i detyruar të pajiset me akt miratimi nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, i cili është i përhershëm për sa kohë nuk ka modifikime apo ndryshime të fushës elektromagnetike të gjeneruar. 4.2. Për pajisjen me akt miratimi për të ushtruar veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues personat fizik më dhe juridikë duhet të përmbushin këto kritere: ...4.2.3. Të jenë të pajisur me vlerësimin për shpërndarjen e rrezatimit nga ekspertë të mbrojtjes nga rrezatimi të njohur nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për çdo burim ose grup burimesh në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”. Pra, sipas këtij akti nënligjor, aplikanti për t’u pajisur me akt miratimi për të ushtruar veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues duhet të paraqesë si dokument aplikimi edhe një akt-ekspertimi të përgatitur me ekspertë.

Sa më lart, sikurse evidentohet edhe në legjislacion, por edhe në kuadër të realizimit së misionit të qëllimit të punës për ZMR-në dhe KMR-në, ekziston një problematikë kryesore e cila konsiston në atë të mungesës së pajisjeve matëse.

Në mungesë të aparaturave që mundësojnë matjet e niveleve të rrezatimit jojonizues rrjedhimisht ZMR-ja nuk mund të realizojë detyrat funksionale sipas nenit 7, të ligjit nr. 10469/2011, të ndryshuar, përkatësisht pikat: ç) Mbledh informacion dhe kryen matjet bazë e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;... e) Mban inventarin për të gjitha matjet e kryera kombëtare të instalimeve dhe rregjistrat e posaçëm për të gjitha matjet e kryera”.

---

<sup>2</sup> <https://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/Manual-mbi-Menaxhimin-Cilesor-te-Punes-se-ZMR.pdf>

Theksojmë se Institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar ndër vite një vëmendje të veçantë trajtimit të ankesave dhe problematikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e qytetarit dhe garantimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit të tyre, duke sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar, ndër të tjera edhe organet e administratës publike për ushtrimin rigoroz të funksioneve dhe përgjegjësi ligjore. Konkretisht, në vitin 2016 institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar me rekomandim me të njëjtin objekt dhe për të njëjtën problematikë Ministrisë së Shëndetësisë për marrjen e masave për rritjen e efektivitetit të aktivitetit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi. Gjithashtu, Avokati i Popullit e ka shprehur edhe mediatikisht këtë qëndrim të mbajtur në rekomandimin e dërguar Ministrisë së Shëndetësisë më datë 23.08.2016<sup>3</sup>. Pra, edhe pse kanë kaluar vite nga rekomandimi i parë i bërë nga institucioni ynë për të njëjtën problematikë për mungesën e aparaturës, sot e kësaj dite kjo gjendje vazhdon të mbetet e pa ndryshuar dhe le përshtypjen se angazhimi i organeve përgjegjëse për të përmirësuar situatën i është lënë harresës.

Theksojmë se, zbatimi i detyrimeve ligjore për çdo organ publik apo privat nuk është opsion. Në këtë kuadër edhe ZMR duhet të insistojë dhe të ngrejë zërin për mungesat dhe pamundësitë që ajo ka në ushtrimin e plotë dhe efektiv të detyrave dhe të funksioneve të saj sipas ligjit.

Ndërkohë, sjellim në vëmendje se të vetmet raporte që rezultojnë të jenë të publikuara për monitorimin e nivelit të rrezatimeve jojonizuese janë ato të realizuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në vitin 2018 “Raport mbi Monitorimin e Nivelit të Rrezatimeve në Rajonin e Durrësit” 4 dhe në vitin 2020 “Raport mbi Monitorimin e Nivelit të Rrezatimeve në rajonet Shkodër, Pukë dhe Kukës” 5, kur ndërkohë nga ZMR-ja e cila është e krijuar me ligjin nr. 10469/2011, të ndryshuar, nuk ka një raport të tillë të publikuar deri më sot dhe as nuk disponon aparatura për të kryer matje të tilla.

---

<sup>3</sup> <https://sot.com.al/aktualitet/ap-zyra-per-mbrojtjen-nga-rrezatimi-te-pajiset-me-mjetet-e-posacme-per-matjen-e-rrezeve/>

Në këtë rekomandim Avokati i Popullit kërkon: “Marrjen e masave të shpejta për parashikimin e blerjes së aparaturave për matjen e rrezatimit jojonizues, të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë efektive nga ana e zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet, në buxhetin e përcaktuar për ISHP-në, mundësisht brenda këtij viti ose maksimalisht për vitin 2017.”

<sup>4</sup> <https://akep.al/wp-content/uploads/2019/10/Raport-rrezatimet-jojonizuese-Durres.pdf>

<sup>5</sup> <https://akep.al/wp-content/uploads/2020/09/Raport-Teknik-per-rrezatimet-jojonizuese-Shkoder-Puke-dhe-Kukes.pdf>

Në të dy raportet përcaktohet se qëllimi ka qenë monitorimi i spektrit të frekuencave, kryesisht emetimeve nga qelizat e telefonisë celulare, veçanërisht pranë ndërtesave të institucioneve publike me ndjeshmëri të lartë, të tilla si shkollat dhe spitalet, për efektin e perceptuar që ata mund të kenë për shëndetin e publikut në komunitetet e tyre, si dhe monitorimi i nivelit të rrezatimeve jojonizuese, marrja dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura nga matjet në terren. Gjithashtu për monitorimin dhe matjet janë kryer duke u përdorur pajisjet: 1. SMP2 Field strength metër; 2. Antena WPF8 – 100kHz – 8GHz. Në këto raporte theksohet se përpilimi i tyre është bërë në bazë të matjeve që Sektori i Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SRF-AKEP realizoi në kuadrin e monitorimit të brezit të frekuencave që përdoren me Autorizim Individual, për të verifikuar zbatimin e standardeve të miratuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jojonizuese (ICNIRP).

Duke iu rikthyer ankesës së ankuesit dhe asaj të banorëve në lagjen në fjalë, duke pasur parasysh edhe faktin e mungesës së pajisjeve në ZMR-në për kryerjen e matjeve të nivelit të rrezatimit jojonizues që emetohen nga stacionet bazë apo qelizat e telefonisë celulare, për dëmet që i shkaktohen individëve si rrjedhojë e ekspozimit ndaj rrezatimeve të tilla, vlerësojmë se në rastin konkret qëndrimi i organeve dhe strukturave përgjegjëse që një problem i tillë nuk ekziston, nuk është i bazuar në ligj dhe as nga ana justifikohet me argumente faktike.

VKM-ja nr. 743/2012 parashikon: “4.7 Për çdo aplikant mbahet një dosje pranë arkivit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi. Ngarkohet Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi për plotësimin dhe mirëmbajtjen e arkivit. 4.8 Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi, pas miratimit nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, përgatit akt miratimit për subjektin përkatës, sipas formatit të miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi. 4.9 Për çdo ndryshim në burim, që vjen si pasojë e ndryshimit teknologjik të shpërndarjes së rrezatimit, personi fizik/juridik duhet të kërkojë ndryshimin e aktit të miratimit dhe të paraqesë vlerësimin përkatës pranë Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi. Në këtë rast, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi vepron si në rastin e një aplikimi të ri. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi vendos për ndryshimin e aktit të miratimit jo më vonë se 60 ditë pune nga data e aplikimit si në rastin e një aplikimi të ri...5. Inspektimi 5.1 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, nëpërmjet inspektorëve të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi, kontrollon zbatimin e dispozitave që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet e të gjitha veprimtarive të miratuara...6. Ndreqja e të metave nga subjekti 6.1 Gjatë ushtrimit të inspektimit, nëse inspektorët konstatojnë të meta në veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizues, i lënë detyra subjektit për ndreqjen e tyre brenda një afati 14 ditësh. Nëse edhe pas këtij afati subjekti nuk ka kryer detyrat e lëna inspektori nëpërmjet Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi, i propozon Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi revokimin e aktit të miratimit të veprimtarisë me burime të rrezatimit jojonizues.”

Sa më sipër, në përmbajtjen e VKM-së nr. 743/2012, shumë qartësisht përcaktohet edhe puna që duhet të kryejë zyra e ZMR-së pas dhënies së Akt-Miratimit fillestar. Pra, parashikohet mbajtja nën kontroll të vazhdueshëm e zbatimit të dispozitave ligjore për të garantuar sigurinë për shëndetin e publikut nëpërmjet inspektimeve nga inspektorët e KMR-së, ku këta të fundit nëse konstatojnë të meta të cilat nuk ndreqen brenda afatit 14 ditor nëpërmjet ZMR-së i propozojnë KMR-së revokimin e aktit të miratimit të veprimtarisë me burime të rrezatimit jojonizues. Vlerësojmë të theksojmë se KMR-ja ka kompetencën për revokimin e këtij akti edhe *post-factum*, në rast se nga ana e ekspertëve gjatë inspektimit konstatohen të meta në veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizues, të cilat ndikojnë në rritjen e rrezikshmërisë së dëmtimit të shëndetit të publikut, i cili ekspozohet ndaj këtij rrezatimi.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit thekson faktin se strukturat përgjegjëse, në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor për mbrojtjen dhe garantimin e një mjedisi sa më të shëndetshëm, nuk duhet të neglizhojnë detyrat dhe përgjegjësitë funksionale, në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, duke vënë në dispozicion të tyre të gjithë mjetet dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare që disponojnë me qëllim përmirësimin e standardit të jetesës.

ZMR në kompetencat funksionale të saj ka si objekt veprimtarie dy funksione atë të kontrollit në praktikë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të akteve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese si dhe atë të monitorimit kryesisht, mbi bazën e ankesave të ushtruara nga subjekte të ndryshme apo edhe kryesisht nga vetë institucioni.

Avokati i Popullit referuar pikës 2, të nenit 7, të ligjit 10469/2011, ku parashikohet se: *“Këshilli i Ministrave përcakton rastet kur inspektorati që mbulon fushën e shëndetit kryen inspektime për zbatimin e rregullave të instalimeve apo veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, si dhe të mënyrës së bashkëpunimit të tij me Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimi”*, është duke vazhduar hetimin administrativ për të përcaktuar nëse ndodhemi përpara veprimeve ose mosveprimeve në kufijtë e ekzistencës ose jo të elementëve me karakter administrativ/penal sa i përket nxjerrjeve së akteve ligjore e nënligjore lidhur me zbatimin me efikasitet të rregullave që mbrojnë drejtpërdrejtë shëndetin e publikut të gjerë nga rrezatimi jojonizues.

Kjo problematikë do të trajtohet në mënyrë të veçantë pas përfundimit të hetimit administrativ përkatës dhe nuk do të trajtohet në këtë rekomandim.

Duke iu rikthyer çështjes në trajtim, ashtu siç edhe theksohet në aneksin “Për kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike (0Hz-300GHz)”, pjesë e VKM-së nr. 743/2012: *“... Ky aneks është i domosdoshëm për të mbrojtur publikun në lidhje me efektet bazë që mund të rezultojnë si pasojë e ekspozimit ndaj fushave elektromagnetike. Masat në lidhje me fushat elektromagnetike duhet t’u sigurojnë të gjithë qytetarëve të komunitetit një nivel të lartë të mbrojtjes nga rrezatimet...Respektimi i kufizimeve bazë dhe të niveleve të referencës duhet të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes, në lidhje me efektet shëndetësore që mund të rezultojnë nga ekspozimi ndaj fushave elektromagnetike...KMR merr në konsideratë progresin e bërë në njohuritë shkencore dhe teknologjinë në lidhje me mbrojtjen ndaj rrezatimeve jojonizuese duke u mbështetur në dokumentat International Commission on Non-Ionizing Radiation Protection (ICNIRP/KNMRJ) dhe Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH) dhe Bashkimi Europian (BE).”*

Sqarojmë se, institucioni ynë nuk konsideron se këto antena janë të dëmshme, por organet e ngarkuara për të ushtruar funksionin e monitorimit dhe të mbrojtjes së publikut nga rrezatimet, duhet të sigurojnë me veprime konkrete se shëndeti publik nuk cenohet prej tyre.

Në këtë prizëm, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe nxitjes së efektivitetit në ushtrimin e kompetencave të organeve administrative në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese dhe ligjit, e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim për ndërhyrje dhe veprim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për përmbushjen e një të drejte dhe standardi për një ambient dhe mjedis sa më të shëndetshëm dhe të sigurt.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj ushtrimin e përgjegjësive ligjore me fokus të veçantë në zbatimin me rigozitet të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim mbrojtjen e qytetarëve dhe individëve, si në rastin konkret të banorëve, të cilët parashtrajnë kërkesën për garantimin dhe përmbushjen e një të drejte.



Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Mosveprimi evident nga ana e strukturave përgjegjëse në këtë çështje nuk i respekton të drejtat e ligjshme të ankuesve, por përkundrazi është bërë shkak për shkeljen e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se:

*“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit...,”*

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrative që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

### **REKOMANDOJMË**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me aparataturat përkatëse të Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi për matjen e nivelit të rrezatimit jojonizues.
2. Marrjen e masave për publikime të raporteve periodike mbi gjendjen e niveleve të rrezatimeve jojonizuese në shkallë vendi.
3. Marrjen e masave të nxjerrjes së një ekspertize në të cilën ankuesi dhe banorët të informohen për nivelin e emetimit të rrezatimit jojonizues të antenës ndaj së cilës janë të ekspozuar; dhe
4. Nëse është rasti, marrjen e masave për spostimin e antenës në tjetër vend ku ekspozimi i publikut nga rrezatimi jojonizues të jetë minimal sipas standardeve të miratuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jojonizuese (KNMRJ)

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

**K O M I S I O N E R E**

**Erinda MELI**